



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-25338 /2021

Klinë: 03.08.2021

PROCESVERBAL

I Seancës së rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës të Klinës, mbajtur më 25. 06. 2021, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, e hapi seancën duke përshëndetur gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje. Kryesuesi përshëndeti te gjithë anëtarët e Kuvendit, Radio "Albës" i uroj 20 vjetorin e themelimit, OSBE dhe OJQ-të. Kryesuesi informoj që prezent janë 23 anëtarë të Kuvendit. Mungon me arsy Tush Dedaj, Baki Gashi i cili ka rast morti, i ka vdekur vëllai dhe i shprehu ngushëllime. Kryesuesi ftoj anëtarët që pas seancës të shkojnë për ngushëllime. Kryesuesi gjithashtu informoj që në këtë seancë mungon kryetari i Komunës me arsy. Dhe po ashtu i uroj suksese anëtarit të ri të Kuvendit, z. Ardiq Marnikut. Kryesuesi gjithashtu informoj që në këtë rend dite nuk ka pikë shtesë dhe hapi debat rreth Rendit të Ditës. Pasi nuk kishte askush për të shtuar asgjë për Rendin e Ditës, kryesuesi e vuri në votim dhe me 23 vota për u MIRATUA Rendi i Ditës.

Para se të filloj mbledhja me rendin e Ditës, kryesuesi falënderoj për punën shumë vjeçare të zyrtares së zyrës për shërbim të Kuvendit, znj. Grishe Gashi e cila do të del në pension këto ditë dhe se kjo është mbledhja e fundit e Kuvendit ku zonja Gashi merr pjesë me shërbimet e sajë. Kryesuesi pati fjalë miradije për znj. Grishe Gashi të cilës ja dha fjalën që të i drejtohet kuvendit me një fjalë rasti.

Znj. Grishe Gashi, shefe e zyrës për punë të Kuvendit: Të falënderoj për mundësinë e dhënë që të i drejtohem këtij kuvendi sot në këtë mbledhje të fundit në të cilën marr pjesë duke i shërbyer. Unë këto ditë do të dal në pension dhe dua të them se jam shumë krenare për kontributin tim shumë vjeçar në të mirë të Komunës, qytetarëve dhe Kuvendit në veçanti. Dua të falënderoj kryetarin e Komunës, kryesuesin për bashkëpunim korrekt, drejtorin e administratës dhe gjithë kolegët më të cilët kam punuar deri tani. Po ashtu një falënderim të veçantë për familjen time që më ka mbështetë vazhdimisht duke nisur prej babit tim i cili pavarësisht kohërave dhe rrëthanave me ka arsimuar dhe mundësuar që të përfundoj fakultetin duke thyer barrierat e kohës dhe hezitimin për arsimimin e femrës. Falënderoj shoqet e mijë dhe gjithë ata me të cilët kam punuar 40 vjet rresht.

Pika 1 e Rendit të Ditës

Kryesuesi konstatoi se mungojnë katër anëtarë

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbal u miratua unanimisht pa asnjë votë kundër

Pika 3 e Rendit të Ditës: Dhënia e betimit të anëtarit të ri z. Ardian Marnikut nga Iniciativa për Klinën duke zëvendësuar anëtarin e më hershëm z. Gjokë Lleshaj.

Z. Ardian Marniku bënë betimin dhe nënshkruan deklaratën e betimit.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga KPF.

Kryesuesi fillon me kërkesat e kaluara dhe rekomanduara nga KPF duke i vënë në votim të gjitha ato të cilat kanë mbetur që ti votoi kuvendi e që anëtarët e kuvendit i votuan rekomandimet e propozuara. Një nga kërkesat të cilat u debatua më së shumti ishte kërkesa për dhënien e parcelës për vendosjen e një busti.

z. Tuna Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Unë pajtohem me konstatimin tuaj që të lejohet vendosja e bustit por jo te epet parcela në shfrytëzim.

z. Enver Berisha: Përshëndetje të gjithëve. Zonja Grishe unë të uroj pensionim të mirë e të shëndetshëm dhe të falënderoj shumë për gjithë atë që ke dhënë për komunën e Klinës. Në lidhje me kërkesën , kjo është diskutuar në KPF dhe jemi dakorduar që të lejohet vendosja e bustit të cilën kërkesë e ka bërë familja Mataj por jo të epet në shfrytëzim hapësira.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Në lidhje me kërkesën e familjes Mataj, mendoj që është meritore vendosja e bustit pasi që personaliteti për të cilin është bërë busti e meriton, ka qenë luftëtar për të drejtat dhe liritë shqiptare dhe ne si grup jemi dakord që të epet leje për vendosjen e bustit.

Kryesuesi duke e formuluar : Lejohet vendosja e bustit në parcelën e kërkuar por jo të epet në shfrytëzim parcela e tillë dhe e vuri në votim ku me vota unanim e MIRATUA. Kërkesa e radhës ishte ajo e bërë nga OVL e UCK për ndarjen e mjeteve ndihmëse për nevojat e kësaj organizate.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Ne kemi shqyrtuar këto kërkesa dhe po ashtu kemi parë edhe mundësitë buxhetore nga duhet siguruar mjetet për këto kërkesa. Jemi pak keq sa i përket mjeteve nga kategoria e subvencioneve pasi që kemi marr një varg vendimesh të më hershme të cilat kanë krijuar shpenzime të mëdha dhe një shumë e madhe e mjeteve nga kjo kategori janë shpenzuar. Në fakt ne mund ta përkrahim pjesërisht këtë kërkesë të Organizatave të dala nga lufta por jo në shumën që është kërkuar. Momentalisht mund të themi se mund të i mbështesim të tri shoqatat me 2.000 euro. Për fillim të i mbështesim me 2000 euro dhe të shohim pas rishikimit të buxhetit e pjesën tjeter. Ndaja të jetë 1000, 500 dhe 500.

z. Enver Berisha: Realisht kur po na vijnë këto lloj orientimesh nga ekzekutivi mua po më bëjnë të habitem dhe befasohem me funksionin që ka ky kuvend. Një gjë nuk e kam të çartë: kërkesat që vijnë në kuvend a duhet gjithmonë ne si asamble të dorëzohemi para propozimit të ekzekutivit apo duhet të analizojmë ne dhe të vendosim. Kërkesat që vijë nga organizatat e tillë nuk janë partiake prandaj duhet të i trajtojmë korrekt. Më vjen keq që këto shoqata mezi mbijetojnë financiarisht. Sikur të ju kishim nda mjete para 6 muajve do të isha dakord me drejtorin dhe shumën e propozuar por nuk ju kemi nda mjete fare. Organizatat e luftës janë fytyra e jonë, është e turpshme që ne të ju ndajmë 500 euro nga buxheti i

Komunës. Ju bëjë ftesë që këto kërkesa të trajtohen më seriozisht dhe të mbështeten saktësisht ashtu siç kanë kërkuar. Nëse s'ka mjete momentalisht, organizata në fjalë do ta kuptojnë këtë. Ne të votojmë dhe miratojmë kérkesën e tyre ashtu siç është bërë e mjetet kur të bëhen të ju epen. Kërko mirëkuptim nga asambleja Komunale dhe të jemi unik e të i mbështesim këto kërkesa të organizatave në fjalë.

Znj. Saranda Elezi: Ne i kemi shqyrtuar këto kërkesa dhe sipas mendimit tim nuk janë vlera të mëdha që janë kërkuar nga organizatat në fjalë prandaj jemi dakord që të ju ndahen.

z. Tunë Dedaj: Unë flas në emër personal e jo në emër të grupit. Kërkoj nga drejtori që të rishikoj edhe një herë mundësinë që këto mjete të ju ndahen. Nëse nuk ka mundësi nuk do të duhej të marrim vendim që nuk mund të realizohen. Pra pyes edhe një herë drejtorin se a ka mundësi të gjinden mjetet e kërkuara nga organizatat.

z. Enver Berisha: Nuk dua të replikoj me Tunën por të bëjë një sqarim. Nëse kjo asamble Komunale e voton gjithë buxhetin e Komunës si nuk po mundet me vendosë për një shumë më pak se 10 mijë euro. Asnje nuk mund ta bindimim se s'mund të vendosim për shumën më pak se 10 mijë euro.

z. Fadil Gashi, kryesues: Në emër të drejtorisë dua që edhe unë të flas dhe të propozoj që të shtohen edhe 1500 euro.

z. Aziz Desku, FEZH: Dua të them që ne si ekzekutiv nuk jemi duke ja cenuar të drejtën e Kuvendit, jeni ju ata që vendosni. Por një vendim kur është marr për buxhetin për këtë vit, ne kemi aprovuar një kategori të subvencioneve me vlerë prej 305.000 euro. Këtë shumë e kemi në dispozicion dhe për këtë mund të marrim vendime sepse është ligj i buxhetit e s'mund ta rrisim. Unë pajtohem me propozimin e kryesuesit që të shtojmë edhe 1500 euro dhe më pastaj të shohim mundësinë e rritje së subvencioneve me rishikim të buxhetit.

z. Enver Berisha: Ne jemi të vetëdijshëm kur është çështja e buxhetit por të paktën që të gjithë të deklarohemi që janë kërkesa të drejta dhe kanë nevojë të mbështeten. Po kërkoj sot që të pakët 50% i kérkesës të aprovohet sot me kusht që 50% tjetër të realizohet me rishikim të buxhetit. Në këtë formë mund të dakordohemi.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Ne këtu jemi që të marrim vendime që mund të ekzekutohen. Ne si grup kuvendar jemi dakord me propozimin e drejtorit por me kusht që me rishikim të buxhetit të përkrahet shuma totale 100% e jo siç kërkoj Enveri 50%.

z. Enver Berisha: Fjala është për 1000 euro pasi që me propozimin ri të drejtorit janë 3500 euro, pra të shtohen edhe 1000 euro dhe të arrihet 50% i kërkessës së bërë ndërsa 50% tjetër të realizohet gjithsesi me rishikim të buxhetit. Ky ishte propozimi im. Pra të ju ndahen tani diku 4000 euro e jo 3500 siç u propozua dhe 4000 tjera me rishikim të buxhetit.

z. Valmir Bacaj: Ne duhet parë mundësitë e drejtorisë së financave sepse ai është kompetent se a mund të gjinden mjetet apo jo sepse është në pyetje më pastaj se a mund të ekzekutohet vendimi.

Znj. Violeta Zefaj: Përshëndetje të gjithëve. Fillimisht unë dua që ta falënderoj znj. Grishe Gashi me rastin e pensionimit, për punën dhe përkushtimin që ka treguar në zyrën për punë të Kuvendit. Gjithashtu Ardian Marnikut të i uroj fillimin e mandatit të ri. Sa i përket kësaj pike, mendoj që është më vend të përkrahet propozimi i drejtorit për financa pasi që besoj se ai e ka analizuar në detaje. Të përfillet zotimi që të ndahen mjetet shtesë pas rishikimit të buxhetit.

z. Fadil Gashi, kryesues: Shuma e kërkuar nga shoqatat janë 9640 euro. Nëse ne sot ndajmë 3500 euro gjithmonë nëse është e mundur dhe mund të gjinden burimet, është mirë. Ju them atyre që nuk e dinë se nganjëherë nuk mund të jua gjesh burimin e marrjes as 10 euro, pra nuk është e lehtë dhe këtë më së miri e din Enver Berisha pasi që ka qenë pjesë e institucioneve që prej pas luftës. Unë besoj që ska në këtë sallë asnjë që nuk dëshiron të ju ndahen ato mjete shoqatave prandaj të gjejmë një dakordim mes vete dhe të mos ndahemi në këtë vendim. Të marrim vendim për ndarjen e 3.500 eurove tanë dhe të obligojmë me te njëjtin vendim drejtorinë e financave që më rishikim buxheti të i ndahet pjesa tjetër(6140 euro).

Kryesuesi e vendosi në votim propozimin e tij dhe me 22 vota PËR asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kërkesa e radhës (e gjashta) e parashtruar nga KV të femrave për përkrahje financiare jo më pak se 10 mijë euro. Kryesuesi pasi theksoi se

drejtoresha e klubit ka bërë kérkesë për të marr fjalën në kuvend për të justifikuar kérkesën dhe se ai ja ka konfirmuar aprovin e dhënieve së fjalës, fjalën e merr drejtoresha e Klubit të Volejbollit "Dukagjini" Klinë.

Znj. Kristina lazri, drejtore e KVV "Dukagjini": Të nderuar anëtarë të Kuvendit. Klubi i Volejbollit te vajzave DUKAGJINI është klub i dytë me lëvizjet ne qytet i cili u themeluar ne vitin 2003 nga komuna e Klinës me rregulloret dhe ligjet e asaj kohe për themelin e klubeve. Me kérkesat shumta te vajzave te shkollave te mesme dhe prindërve te vajzave klubit është riaktivizuar në vitin 2015. Nga vitin 2015 ky klub merr pjesë aktive në garat e Republikës së Kosovës në ligen e pare, Klubi në përbërjen e saj ka 25 anëtarë aktive t'ë Senioret ndërsa nga 2020 ka hapur edhe Akademinë e Volejbollit ku për momentin aktive kemi 25 vajza t'ë moshave t'ë ndryshme. Pavarësisht kushteve pandemike me t'ë cilat jemi përballur në vitin 2020/21 arritëm te mobilizohemi dhe t'ë aktivizohemi maksimalisht q'ë këtë vite t'ë kemi rezultatet e duhura. Falë këtij angazhimi t'ë vajzave dhe pse n'ë kushte jashtëzakonisht t'ë vështira ne arritëm qe me 17 maj 2021 t'ë shpallemi kampion i Ligës së Parë të Kosovës duke ja dhuruar qytetit të Klinës kupon e parë në këtë disiplinë sportive. Klubi i Voljebollit t'ë femrave DUKGJINI duke u bazuar ne thirrjen publike të DKRS dt. 21.04.2021 për subvencionimin e aktiviteteve sportive kishte dërguar me kohë projekt propozimin për mbështetje financiare. Drejtoria gjegjes hapi konkursin duke u thirru në rregulloren e MF 04/2017 e cila përcakton saktë kushtet dhe kriteret se si duhet vlerësuar një aplikacion. Pasi që komisioni i caktuar nga ana e komunës sipas kësaj rregullore nuk ishte profesional, bënë disa shkelje të rregullores dhe për shkak te kësaj ne u dëmtuam si ekip. Komisioni beri shkelej të rregullores duke anashkaluar rezultatet tonë si kampion, pastaj mbështetjen e sporteve femërore që duhet t'ë jetë prioritet sipas kësaj rregullore dhe shumë shkelje të tjera që i kam cekur në ankesë. Ankesën e dorëzuam si klub, por është rikthyer vendimi si i pa bazuar duke mos me dhanë asnjë arsyesh pse është i pabazuar. Normalisht se edhe komisioni i ankesave ishte jo profesionale sepse nuk kishte ne përbërjen e ti asnjë jurist .

Të nderuar anëtarë dhe anëtarë të Kuvendit, po ju kërkoj si një dashamirëse e sportit dhe rezultatet që kemi arritur si klub t'ë mbështetini kérkesën time minimale.

Dua të citoj një shkrimtare angleze(GLORIA STEINEM) e cila thotë;

FEMININISTË ËSHTË KUSHDO QË NJEH DHE VLERESON BARAZINË DHE VLERAT SI TË FEMRAT ASHTU DHE TË MESHKUJVE . andaj sot sidomos nga ju kërkoj të paktën barazi . Ju faleminderit

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. E përgëzoj drejtoreshën e Klubit për sukseset e arritura. Për kërkesën e saj më së miri do të na jep informacione drejtori i financave por unë dje kam takuar dy përfaqësues të klubeve sportive dhe ata kanë kërkuar që të shihet mundësia që të gjitha klubet të përkrahen në mënyrë të barabartë.

z. Arben Limanaj: Ne e mbështesim kërkesën e klubit të volejbollit të femrave duke e ditur që Kлина ka pasur histori të mirë të suksesit të klubeve të femrave por gjithmonë duke pasur parasysh mundësinë financiare që ekziston. Unë e kam parë që një klub që funksionon në Klinë i është ndarë nga subvencionet një shumë tepër e vogël me të cilën nuk mund të funksionojnë. Edhe unë kërkoj që jo vetëm klubit të volejbollit por edhe klubet e tjera të vogla që janë diskriminuar në një far forme që të ndihmohen e sidomos klubet e femrave që ne si institucionet duhet të tregojë kujdes dhe të i mbështesim.

Znj. Violeta Zefaj : Mendoj që kërkesa e Klubit të Volejbollit " Dukagjini" është shumë e arsyeshme pasi që klubi ka arritur sukseset por edhe për shkak të specifikave të klubit. Përkrahja ime është në maksimum.

Znj. Shukrije Shala: Mbështes kërkesën e drejtoreshës dhe e kuptoj gjithashtu mundësinë e drejtorisë së financave por se nevoja për përkrahje është shumë e madhe.

z. Petrit Palushaj: Po e shfrytëzoj rastin që znj. Gashi të i uroj pensionimin dhe të i uroj gjithashtu shëndet e pensionim të mbarë. Po ashtu edhe z. Marniku i uroj sukseset në mandatin e ri të marrur dhe përfaqësim dinjitoz të elektoratit të tij në Kuvend. Sa i përket kërkesës së Klubit të Volejbollit " Dukagjini" e dijë pak a shumë gjendjen financiare dhe kushtet e Klubit i cili me ato kushte të rënda ka arritur të bëhet kampion i Kosovës në ligën e parë . Prandaj ftoj edhe kolegët asamblist që ta përkrahin kërkesën e Klubit sepse është shumë e arsyeshme.

z. Enver Berisha: Sa herë që dal në foltore dijeni që nisem nga një lloj dakordance që marrim në KPF për temat që vijnë këtu edhe pse nuk më

pëlqen nganjëherë sepse po devijojnë temat. Po nisi me drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Kjo Komunë a ka ekzekutiv? A e din DKRS që ka klube në Klinë që funksionojnë jo vetëm në këtë mandat por edhe më përpara? A duhet të bëhet planifikimi i subvacioneve në bazë të Klubeve që i kemi? Të thuhet tani se s`po gjemë mjete për të subvencionuar këto Klube që i kemi ditur që i kemi dhe jua dimë rezultatet e arritura, vërtetë ne si asamble po e humbim kuptimin. Këto gjëra me kohë duhet të planifikohen. Asnjë subjekt politik nuk mund të thirret në adresën e ndonjë klubit. Klubet ajnë të pavarura. Pak më vonë e kemi një kërkesë tjetër për të cilën do të dakordohemi shumë lehtë dhe është kërkesë e madhe. Nuk po arrijmë të dakordohemi për klubet më të vogla dhe kjo më çuditë. Nuk besoj që ka pasur ndonjë herë ndonjë klub i femrave që ka pasur rezultate më të larta se sa Klubi i Volejbollit të Femrave "Dukagjini" prandaj duhet gjetur mundësitë dhe të mbështetet kërkesa e tyre. Nëse ne duam të kemi rezultat dhe të kenë motiv ato vajza që zhvillojnë aktivitet sportiv, ne duhet të i mbështesim finansiarisht. E uroj KVV "Dukagjini" për suksesin e arritur dhe kontributin e dhënë në angazhimin e vajzave të reja në Klub. Sukseset e klubeve duhet të stimulohen ashtu siç bëhet në tërë botën. Jam dakord që të mbështeten gjithashtu edhe klubet e tjera që përmendi Esati dhe gjitha klubet sportive që funksionojnë në Komunën e Klinës.

Znj. Saranda Elezi: Ne si shoqëri e kemi obligim që të mbështesim klubet sportive të femrave dhe tjerë prandaj në emër të grupit e mbështesim kërkesën e Klubit të Volejbollit "Dukagjini".

z. Tunë Dedaj: Për mua është vendim qesharak i Ministrisë së Sportit që KVV "Dukagjini" edhe pse është shpallur kampion i ligës së parë, vazhdon të garoj në ligën e parë akoma, është dashur që të futen në super ligë. Pyes drejtorin e financave se a ka mundësi të ju epen mjetet e kërkuar 10 mijë euro. Një kërkesë për drejtorin e DRKRS: është dashur që të shikohet më herët mundësia e subvencionimit të klubeve.

Znj. Xhezide Gashi- Trepça: Përshëndetje për të gjithë. Unë fillimi isht i uroi Grishe Gashit pensionimin, i uroj gjithashtu edhe antarit të ri mandatin e filluar. E morra fjalën për ta mbështetur kërkesën e drejtoreshës së Klubit duke u bazuar në të arriturat dhe sukseset e klubit. Kërkoi që të mbështetet kjo kërkesë në bazë të mundësive buxhetore që janë.

z. Xhevxhet Berisha: Përshëndetje. Çdo kérkesë që vjen për subvencionim duhet përkrahur po ashtu duhet të shihet edhe numri i anëtarëve që veprojnë brenda klubit. Edhe kérkesën e Kristina Lazrit jam dakord që të përkrahet ashtu siç do të jam dakord që të përkrahen të gjitha klubet e tjera. Për informim edhe klub i futbollit të femrave është dy herë kampion i Kosovës në ligën që garon.

z. Enver Berisha: Një vendim që ne e kemi nxjerr në vitin 2018 për përkrahje këtij Klubi në vlerën 4000 euro, nga këto 2000 euro nuk ju kanë dhënë këtij klubi sot e asaj dite. Do të duhej të shikohet pse jemi ne këtu dhe pse marrim vendime që nuk ekzekutohen.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse ju referohemi shumave që deri tani kur po flasim, ato kapin vlerën e 70 mijë eurove. Më thoni se a më prioritet është që të hiqen subvencionet nga bujqësia e të dërgohen në sport apo nga sporti në një drejtori tjetër? – Nuk është lehtë aspak, heqim diku e ngarkojmë diku por gjithsesi diçka do të lejmë keq. Kemi një kérkesë në vazhdim që është 50 mijë euro. Është pak më e lehtë sepse është më e definuar sepse na ka dhënë drejtim se nga me i marrë. Sidoqoftë nëse vendosim dhe japim mjete ne duhet të kemi një raport kthyes që tregon se nga kanë shkuar ato mjete. kur nuk planifikohen mire mjetet e subvencioneve atëherë po ndodhë që në qershori të harxhohen mjetet. Jemi dakord të gjithë që të përkrahen këto klube sepse janë rini e jona por trajtimi i klubeve duhet të janë barabartë bazuar në shpenzimet që kanë. Shpenzimet nuk janë të barabarta për të gjithë, duhet të bazohemi në shpenzime nëse duam të i trajtojmë barabartë.

Znj. Kristina Lazri: Nuk dua të bëjë krahasime, nuk më pëlqen. Nuk do të duhej të bëhen krahasime të shpenzimeve sepse te klubin ynë shumica e vajzave luajnë pa asnjë pagesë ndërkaq në Klubin tjetër marrin rroga. Në klubin tim jepen shpenzimet e një loje, autobusi, ushqimi i ditës etj. Sikur të kisha mjete edhe unë do të ju ipja rroga vajzave që luajnë në klub.

z. Fadil Gashi, kryesues: Besoj që ne nuk jemi duke nda mjete për të ju dhënë rroga. kanë ardhë kérkesa të reja dhe ne nuk mund të mos i trajtojmë barabartë. Barabartë është kur të ju ndajmë mjete në proporcion të shpenzimeve që kanë e jo për marrje të pagave. Ta keni parasysh se duhet të vendosim për të gjitha klubet se në seancën tjetër do të kemi kérkesa të reja nga klubet.

z. Aziz Desku, Drejtor i FEZH: Ne sot po shqyrtojmë një kërkesë dhe ka indikacione që do të ketë edhe kërkesa të tjera nga klube të tjera që veprojnë në komunën e Klinës. është një rregullore e MF nr. 4/2017 e cila përcakton që OJQ financohen vetëm për mes thirrjes për aplikim dhe që kjo është në kundërshtim me rregulloren tonë për ndarjen e subvencioneve, pra ne kemi qenë dhe jemi në kundërshtim me këtë rregullore të ministrisë së financave. Ne duhet fillimisht që të sigurojmë mjetet dhe më pastaj të respektojmë këtë rregullore dhe të bëjmë një thirrje të re. Nëse marrim sot një vendim sikurse ai i më parshim do të jetë në kundërshtim me rregulloren që përmenda dhe do të jetë objekt i auditorit për vitin e ardhshëm. Mirë do të bënim që të presim rishikimin e buxhetit dhe më pastaj të bëjmë një thirrje për të gjitha klubet e të trajtohen kërkesat një nga një bazuar në rregullore.

z. Fadil Gashi , kryesues: Fjalën ja jap Skënder Merturi, drejtor i DKRS.

z. Skënder Merturi, drejtor i DKRS: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për asamblistë. Fillimisht dua ta përshëndes znj. Grishë që ka dalë në pension duke i uruar shëndet dhe gjësim të pensionit. Asamblist të ri, urime detyrën e re dhe suksese. Ne jemi duke e zbatuar rregulloren e Ministrisë 04/2017 e cila na obligon për ndarjen e subvencioneve. Çdo fillim vit, sa herë të hartohet buxheti që asamblistët e votojnë, bëhet planifikimi për ndarjen e subvencioneve dhe të gjitha OJQ-ve, klubet trajtohen si OJQ, ashtu i ka kategorizuar ligji e që përmend tim është gabim që klubet sportive trajtohen si OJQ por ne vazhdojmë me e respektuar këtë kategorizim. Në thirrjen publike që e ka bërë DKRS është bërë subvencionimi nga një komision vlerësues të gjitha ato OJQ që kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Ka pasur edhe klube edhe OJQ që janë përjashtuar nga subvencionimi për shkak të mos dorëzimit të raportit kthyes që u përmend nga kryesuesi. Kemi dy raste kur dy OJQ nuk e kanë bërë raportin kthyes qysh duhet, komisioni vlerësues i ka përjashtuar nga thirja. Po ashtu janë edhe 5 shkolla sporti që janë përjashtuar nga thirja publike shkaku i raportit kthyes. Mendoj që komisioni vlerësues ka bërë vlerësim të drejt dhe ne si DKRS kemi subvencionuar aq sa kemi pasur buxhet. Unë ju kisha lutë që të jemi të vëmendshëm qysh po i trajtojmë kërkesat sepse sot kanë qenë dy kërkesa e në seancën tjetër do të vijnë dy e kështu më radhë. Nëse i trajtojmë kështu do të futemi në një rrugë që s'kemi me pasur mundësi me dalë. Kërkesën e klubit në fjalë. Komisioni ka

vlerësuar aq sa i janë nda klubit. Se a është bërë vlerësim i duhur apo jo, unë nuk e dijë, është punë e komisionit. Unë ju sugjeroj që nëse dikush dëshiron të formoj një klub, fillimisht le të gjënë donator për financim sepse ne jemi të obliguar që të zbatojmë ligjin dhe mundësinë buxhetore që kemi. Për mendimin tim, klubet veprojnë si OJQ të pavarura, është obligim i tyre që të gjejnë mjetet buxhetore që të veprojnë. Ne si Drejtori subvencionojmë aq sa kemi mundësi.

z. Enver Berisha: Nëse vjen në krye të Komunës a do të rritni shumën e subvencionimit të Klubeve?

z. Skënder Merturi, drejtor i DKRS: Unë deri tani fola si drejtor aktual dhe nuk jam duke bërë fushatë politike. I dëgjoja të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe thënë të vërtetën pati fushatë elektorale në fjalimet e disa prej tyre.

z. Enver Berisha: Dua që të ndërlidhem me fjalën e drejtorit Merturi. E para, vitin e kaluar kanë mbetur mjete suficit e të cilat kanë mundur të ju jepen klubeve. E dyta, rregullorja nuk parasheh shumën që duhet dhënë por parasheh kriteret se si duhet të bëhet vlerësimi. Tani, a ka qenë komisioni vlerësues vigjilent që të i trajtojë qysh duhet këto aplikime? Le shumë për të dëshiruar. Ose a ka pasur interferim në Komision se qysh me vepruar? Është e drejta ime që të dyshoj që ka pasur. Po e përsëris edhe një herë: Po pretendojmë që të i trajtojmë barabartë të gjitha Klubet por po harrojmë rezultatet e arritura nga Klubi i Volejbollit të femrave "Dukagjini". Bazuar në suksesin e arritur nga Klubi në fjalë, ky klub meriton trajtim dhe vlerësim më të madh se që i është bërë.

z. Petrit Palushaj: Ne e dëgjuam drejtorin dhe shpjegimin që dha ai. Ai tha se të gjitha klubet janë OJQ. Kam një pyetje për drejtorin: Tani pas kësaj kërkesë do ta shqyrtojmë një kërkesë tjetër nga Klubi i futbollit "Dukagjini", a është edhe KF "Dukagjini" OJQ? Nëse po atëherë po del një pabarazi në trajtimin e duhur të klubeve. Sipas thirrjes bazuar në vendimin e Ministrisë, a trajtohen të gjitha klubet nyejt apo ka dallime?

z. Arben Limanaj: Edhe unë pak a shumë kam shqetësim të njëjtë me parafolësin, Petritin. Tani a kemi të drejt ne si Kuvend të vendosim për shuma e ndarje të mjeteve pasi që udhëzimi administrativ thotë se pa thirrje publike nuk mund të ndahen mjete në këso rastesh? Shqetësim tjetër. Udhëzimi administrativ që ka nxjerr Ministria nuk është në harmoni

me rregulloren Komunale për subvencione, a duhet harmonizuar këto dy dokumente?

z. Tunë Dedaj: KF "Dukagjini" dhe KVF "Dukagjini" janë kampione dhe duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Nuk mundet që të subvencionohet njejtë një klub që është në vendin e fundit me klubin që ka hy në superligë. Një shembull: Nuk mund të trajtohet barabartë KF "Dukagjini" që ka hy në super ligë me KVF "Dukagjini" që është kampion por që garon në ligë të parë. Unë i përkrahu të gjitha klubet por këto dy klube me gjithë dallimet e tyre në garime, kanë pasur suksese prandaj është mirë të trajtohen veçantë.

z. Ajet Sejdiu, zyrtar FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Desha që të ndërlidhem në temën që po diskutohet. Rregullorja komunale për subvencionimin e Klubeve shumë mirë e definon se qysh duhet të subvencionohen klubet sportive, prandaj nëse ne marrim vendim sot në mos respektim të kësaj rregulloreje dijeni që vendimi ynë ka me u kthyë i jashtëligjshëm. Në rregullore shumë çartë janë përcaktuar procedurat se si subvencionohen OJQ e që DKRS ka vepruar në harmoni me këtë rregullore. Ju si Kuvend mund të dyshoni në vlershmin e bërë nga Komisioni vlerësues por për mënyrat e tjera të ndarjes do të bini ndesh me rregulloren në fjalë. Dhe po, pajtohem me atë që e tha Arben Limanaj. Ne duhet që të bazohemi në udhëzimin administrativ dhe rregulloren tonë ta harmonizojmë me atë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kemi dy dilema tani. 1- kemi një rregullore të votuar në Kuvend, jo në këtë legjislacion por ajo është në fuqi dhe 2. Një udhëzim administrativ që ka ardhur nga Ministria e që rregulloren tonë ose duhet anuluar ose plotësuar dhe harmonizuar me atë udhëzim. Çka duhet të bëjmë tani? Të procedojmë me nxjerrjen e një vendimi për ndarje të mjeteve sipas kërkesave të bëra nga klubet apo të ndërpremë. Me gjithë këtë kushdo që të thirret në rregulloren e Komunës ka të drejtë sepse ka fuqinë juridike kjo rregullore derisa nuk është anuluar apo ndryshuar pavarësisht mos harmonizimit me udhëzimin administrativ të ministrisë. Tani se a duhet të veprojmë sipas udhëzimit apo sipas rregullores meqenëse jemi në këtë situatë, nuk e kemi zyrën ligjore këtu që të na tregoj. Nëse ne marrim vendim që të ju ndajmë mjete klubeve sot, ka mundësi që vendimi ynë të kthehet i paligjshëm dhe edhe përfomanca e

jonë si Komune dhe Kuvend do të dobësohet. Pas kësaj pike e kemi Kornizën afatmesme buxhetore, ndërhyjni aty dhe orjentone buxhetin, nuk bëhet asgjë nëse presim edhe një muaj dhe nuk vendosim sot për ndarje të mjeteve për klubet. Veç sa për indo, buxhetin që e kemi miratuar për këtë vit, DKRS për subvencione i ka vetëm 64 mijë euro. Nëse ne sot marrim vendim për ndarje të mjeteve për klubet sipas kërkesave të tyre s`kemi ku marrim mjete sepse ato veç janë shpenzuar deri tani, shto kësaj edhe dilemën juridike se a kemi të drejt apo s`kemi të drejt.

Z. Valmir Bacaj: Në fakt nuk është hera e parë që ne si Kuvend marrim vendime për subvencionim të klubeve me këtë rregullore që është në fuqi. Unë e shoh që kjo kërkesë e Klubit të femrave është bazuar në këtë rregullore dhe gjithashtu e shoh që shumica e anëtarëve të Kuvendit janë dakord që të përkrahët kërkesa e klubit. Në të kaluarën kemi marr vendime bazuar në këtë rregullore dhe të natyrave të njëjtë. Unë propozoj që përsye të sukseseseve të treguara të Klubit dhe për shkak se siç u tha edhe vitin e kaluar ju kemi mbetur borxh pa jua dhënë shumën që ju ka nda(2000 euro borxh), që ta votojmë edhe këtë kërkesë të klubit dhe në të ardhmen të shohim për harmonizim të rregulloreve në fjalë.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Ne vetëm në vitin 2018 kemi mbetur borxh shkaku se nuk është ditur udhëzimi administrativ. Përndryshe në vitin 2019 dhe 2020 nuk janë nda mjete shtesë përmes kuvendit por vetëm përmes thirrjes publike. Për KF “Dukagjini” është transfero i mjeteve nga kategoria e subvencioneve nga drejtoritë e tjera në drejtorinë e Kulturës me qellim të ndarjes së mjeteve për Klabin e futbollit “Dukagjini”. Mendoj që duke formuar një komision të ri vlerësues dhe një thirrje publike do të përfshiheshin të gjitha, edhe këto kërkesa edhe ato që mund të bëhen nesër edhe ato të Organizatave të luftës dhe në këtë mënyrë do të ishim konform ligjit e rregulloreve.

z. Fadil Gashi, kryesues: Propozoj që të hiqen të gjitha përveç asaj të kornizës afatmesme buxhetore dhe brenda 10 ditëve të takohen kryetari i Komunës, drejtori i financave dhe drejtori i Kulturës , të bëhet përgatitja edhe juridike edhe financiare dhe të thirret një seancë e jashtëzakonshme.

z. Tunë Dedaj: Unë do të doja që ne sot të marrim një vendim për këto dy klube, ndërsa për kërkesat e klubeve të tjera të shihet mundësia në një seancë të jashtëzakonshme.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse marrim vendim për këto dy klube sot atëherë po bëjmë pabarazi. Nuk mund ta veprojmë për dike ndryshe prej të tjerëve.

z. Enver Berisha: Kryesues faleminderit për fjalën. Dëshiroj të jap vetëm një informacion dhe më pastaj shkojmë sipas propozimit tuaj. Le ta dij edhe asambleja se në kuadër të formimit të komisionit për vlerësimin e ndarjes së mjeteve ka pasur shkelje. Në kuadër të komisionit, zotëria drejtor është dashur që ta ketë një përfaqësues nga drejtoria e tij. Lind pyetja kush e bëri komisionin?

*ndërhyjnë drejtori i Kulturës, z. Skënder Merturi në fjalën e z. Enver Berisha. Më pastaj intervenon kryesuesi duke e këshilluar drejtorin që mos të ndërhyjë dhe se për të marr fjalën duhet kukuar nga kryesuesi. Drejtori Skënder Merturi dëgjohet të thotë(mikrofoni i ndalur) se në kuadër të drejtorisë në Komision ka qenë Taulant Berisha, ndërsa z. Enver Berisha i thotë se është duke folur ai dhe se duhet pritur deri ta përfundoj. Ndërkajtë të njëjtën gjë ja thotë edhe kryesuesi. Drejtori, z. Skënder Merturi reagon përsëri dhe thekson se edhe ai është duke folur dhe se nuk lejon që të rrej duke ju drejtar me emer Enver Berishes. Edhe z. Enver Berisha ja kthen njejt duke i thënë se ai nuk po rren por po rren ti. Kryesuesi kërkon nga drejtori Skënder Merturi që ta tërheq fjalën e thënë – po rren, ndërsa drejtori nuk e tërheq. Pas një debati interaktiv dhe pas tërheqjes së vërejtjes nga kryesuesi se mund të marr masa duke kërkuar që të liroj mbledhjen drejtori, drejtori Skënder Merturi nuk pranon që ta tërheq fjalën – po rren në drejtim të Enver Berishës. Kryesuesi i Kuvendit kërkon nga z. Skënder Merturi që ta liroj sallën, ashtu edhe ndodh: Drejtori i DKRS e liron sallën e kuvendit.

z. Enver Berisha: Të vazhdoj aty ku e nisa e më ndërhyjnë në fjalë. Përmua është komisioni vlerësues që nuk e ka kryer punën siç do të duhej përndryshe unë dhe grapi kuvendar i PDK dakordohemi për një seancë të jashtëzakonshme.

z. Petrit Palushaj: Edhe ne si grup kuvendar dakordohemi që të kemi seancë të jashtëzakonshme me kush që të gjitha klubet të trajtohen barabartë.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi e vendos në votim propozimin që brenda 10 ditëve të përgatitet infrastruktura ligjore dhe financiare dhe

të thirret një seancë e jashtëzakonshme. Me 24 vota për, asnë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika e 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i draft kornizës afatmesme buxhetore 2021-2024.

Kryesuesi theksoi se për këtë draft kornizë është mbajtur një debat publik dhe edhe pse ka pakënaqësi për numrin e vogël të pjesëmarrjes së publikut, ai debat është zhvilluar dhe janë nxjerr disa ide dhe propozime. Gjithashtu kjo kornizë buxhetore është shqyrtuar edhe në KPF.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Do të mundohem të jem sa më i shkurtër në fjalimin tim. Dua të them se korniza afatmesme buxhetore është dokumenti bazë mbi të cilin do të bëhet përgatitja dhe hartimi i buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për 2023 dhe 2024. Korniza afatmesme buxhetore pason kornizën afatmesme të shpenzimeve të qeverisë së Kosovës e aprovuar në muajin Prill. Kjo kornizë afatmesme komunale buxhetore është bazuar gjithashtu në Kornizën zhvillimore ekonomike Komunale 2017-2021. Më pastaj kanë pasuar qarkoret financiare nga Ministria e Financave dhe kufijtë buxhetor për vitin 2022 dhe vlerësimet për 2023 dhe 2024. Në bazë të këtyre kufijve fillestar buxhetor parashihet që Komuna e Klinës për vitin 2022 të ketë një buxhet në vlerë prej 11 milion e 333 mijë e 332 euro duke përfshirë të gjitha grandet.

Drejtori i financave tregoj për burimet e financimit dhe për parashikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe 2024. Po ashtu drejtori Desku shpjegoi edhe për kategoritë veç e veç dhe shumën e planifikuar për vitin 2022.

Në fund të fjalimit të tij, drejtori theksoi se është hera e dytë që shqyrtohet në Kuvend kjo kornizë dhe se ka pasur kohë të mjaftueshme. Gjithashtu janë mbajtur takime e debate me publikun gjithandje bashkësive lokale të Komunës së Klinës.

Kryesuesi theksoi se pas miratimit të këtij drafti menjëherë do të nis ndërtimi i buxhetit dhe para se ta vëjë në votim ai hapi debat.

z. Enver Berisha: Pa dashur që të i bëjë shumë analizë vlersimëve dhe propozimeve të kësaj strategjie dëshiroj që të i ngris tre katër çështje. 1. Ne po provojmë që të aprovojmë strategji për vitet vijuese ndërkohë që nuk janë përbushur zotimet e para që janë dhënë nga kryetari i Komunës. Po e nisi nga premtimi i ujit të pijshtëm që nuk është realizuar dhe as nuk është

temë më. Kemi projekte infrastrukturore që janë nënshkruar disa memorandume me kryetarin Bashota dhe Ministrin e të njëjtat janë nënshkruar nga kryetari aktual e që nuk janë kryer akoma. Shtati i Lumit "Drini i bardhë" që ka mbetur pa përfunduar. Është bërë një ndërhyrje aty, një puna pa efekt që më shumë ka bërë dëme se sa mirë. Po i përmend këto shqetësimë se kur vjen puna të buxheti duhet ta dimë se a do të kryhen ato që shkruhen apo jo. Jam i detyruar që ta them këtu shqetësimin rreth punimeve që po bëhen në shesh. Kontrata për përfundimin e punimeve ka qenë tre vjeçare. Pse u dashtë që të pritet 5 vjet që të përfundoj ky shesh dhe tani të bëhen riparime. Jua them se për mbikëqyrjen e punimeve në këtë shesh ka qenë një kompani nga Deçani. Po ashtu rreth projekteve, janë kryer projekte të pa planifikuara dhe të votuara në këtë Kuvend. Po ashtu ka ndodhë që pas dakordimit dhe marrëveshjeve për disa projekte që kemi bërë me kryetarin e Komunës ato absolutisht nuk janë përbash. Prandaj, duke u bazuar në këtë vijueshmëri të premtimëve të pa mbajtura, projekteve se si janë zhvilluar, ju vendosni vet pa grupin tonë kuvendar.

Z. Valmir Bacaj: Ne si kuvendar të grüpit të Aleancës i japim mbështetje të fortë aprovimit të kësaj Kornize afatmesme buxhetore si një nga dokumentet kryesore mbi të cilën do të hartohej buxheti për vitin 2022 dhe konsiderojmë që kjo kornizë bazohet në parashikime reale.

Znj. Violeta Zefi: Besoj që janë përfshi dhe janë degju me kujdes kérkesat e shqetësimet që kanë ardhur nga dëgjimi me qytetarë. Edhe ne si grup kuvendar e mbështesim këtë Kornizë buxhetore afatmesme.

Kryesuesi i Kuvendit e vuri në votim Kornizën afatmesme buxhetore Komunale dhe me 16 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 6 e rendit të Ditës: Formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentët të Komunës së Klinës.

Kryesuesi theksoi se është Rregullorja për ndarjen e bursave është i formuar dhe se komisioni në fjalë përbehet nga pesë anëtarë që duhet të votohen në Kuvend. Dy nga Kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Do të ndahen 30 bursa dhe vlera e shumës së një burse është 50 euro.

U propozuan: Besart Hoti, Lirim Gashi, Suzana Gjergji, Binak Sylaj dhe shoqëria civile.

Të gjitha grupet kuvendare ishin dakord me numrin e bursave dhe shuma e caktuar.

Anëtarët e propozuar për komision u vendosën në votim dhe me 23 vota për, asnë kundër dheasnë abstenim u MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i vendimeve të rikthyera për rishqyrtim nga ministria e pushtetit lokal

Kryesuesi sqaroi se për cilat vendime është fjala: Vendimi me nr. 06-1405\21, 14294\21, 14306\21. Ai theksoi se për hartimin e planit zhvillimor e kanë pranuar sqarimin nga drejtoria. Ai propozoi që për hartimin e planit të na dërgoi edhe një sqarim drejtoria ndërsa dy vendimet e tjera të i pezullojnë derisa të vije një sqarim i duhur.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizimit: Përshëndetje të gjithëve. Ne kemi qenë në Ministrinë e Ambientit dhe ju kemi treguar që për planin zhvillimor i kemi nisur procedurat e hartimit. Me nisjen e procedurave nënkuftohet se 18 muaj zgjasin këto procedura. Por edhe programin që ne e kemi bërë për këtë rast, shërbimi i kuvendit nuk e ka dërguar në Ministri. Kjo është një çështje teknike që ne jemi të detyruar ta bëjmë edhe pse nga ministria me një telefonatë ta kërkonin ne do të jua dërgonim, e sot s`do të kishim nevojë të kishim këtë kërkesë prej tyre për rishikim. Nuk ka asgjë më shumë seriozitet. Na duhet vetëm edhe një herë që ta bëjmë votimin e inicimit të procedurave.

z. Fadil Gashi, kryesues: Me të drejt apo pa të drejt ne jemi të shtrënguar që të votojmë edhe një herë inicimin e procedurave për hartimin e këtij plani. Unë në fakt e kam konfirmimin zyrtar nga shërbimi i kuvendit që atyre në ministri jua kanë dërguar me kohë por si duket ata nuk e kanë parë me kohë dhe kanë sjellë këtë kërkesë për rishikim që ne duhet ta bëjmë. Kush është për?

Me vota unanim, u MIRATUA

Kryesuesi theksoi se dy vendimet e tjera u pezulluan dhe vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e planit zhvillimor u harmonizua sipas kërkesave të Ministrisë. Ky do të jetë edhe njoftimi për Ministrinë e linjës.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje.

- z. Sefa Morina:** Dua që në emër të grupit Kuvendar të LDK të falënderoj përzemërsisht znj. Grishe Gashi për shërbimin e dhënë në Komunë. Kam një kërkesa është nga Osman Morina dhe kërkon që të ndërtohet kanalizimi në lagjen Morina në Ceskovë.
- z. Valmir Bacaj:** Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, z. Iber Elezaj në lidhje me kontratën për trajtimin e qenve endacak. Sipas asaj që shihet, përkundër kontratës që kemi me kompaninë për trajtimin e këtyre qenve, gjendja në teren nuk po ndryshon.
- z. Iber Elezaj, drejtor i Shërbimeve Publike:** Kontrata vazhdon të jetë valide, menaxher për këtë çështje është inspektori sanitar i Komunës z. Ardián Zefaj dhe mendoj që është duke e kryer punën shumë mirë. Trajtimi i qenve është bërë sipas kërkësës së qytetarëve kur qenët kanë qenë të rrezikshëm. Konkretisht nuk kam të dhëna por mund të jua sjellë në seancën e ardhshme. Qenët që trajtohen, kthehen prapë në vendim ku janë marrë prandaj ndoshta duket sikur s'ka ndryshuar asgjë në teren. Pas trajtimit llogaritet që qentë nuk janë të rrezikshëm për njerëzit as në aspektin shëndetësor dhe as të kafshimit. Ne duhet të besojmë në këtë dhe të mësohem i shohim qenë e maca në mesin e shoqërisë tonë.
- z. Asdren Ramadani:** Pyetje për z. Lorenc Marleku. Në seancën e kaluar kur kemi pyetur se pse nuk i keni përfshirë disa shtëpi dhe biznese në rrjetin e kanalizimit, ju thatë se projekt i nuk kishte përfunduar dhe se në fazën e dytë do të përfshihen. As sot ato biznese dhe shtëpi nuk kanë rrjet kanalizimi. Pa rrjet kanalizimi dhe ndriçim publik nuk kanë mundësi të zhvillohen e kjo nuk është e drejt pasi që arka e komunës mbushet edhe me kontributet e tyre. Pyetja tjetër. Nuk mund ta kuptoj sipas cilit kriter teknik një kompani ndërtimore e prenë asfaltin në dy vende në largësi tre metra nga njëra prerje prej tjetrës? Fjala është përrugën në fshatin Dollovë si dhe në rrugën e Gjimnazit. Si ka mundësi të pranohen teknikisht ato rrugë dhe të prishen menjëherë. Po ashtu un si anëtar i Kuvendit vazhdimisht kam bërë kërkesa por asnjëra nga to nuk është shqyrtuar dhe realizuar deri me tanë.
- z. Enver Berisha:** Çfarë po ndodhë me serat, drejtor i Bujqësisë? Që sa kohë kanë nisur dhe nuk përfunduar. S'ka mjete në drejtori? Ti kanë marr për punë tjera mjetet apo si është problemi?

- z. Naser Morina, drejtor i Bujqësisë:** Përshëndetje të gjithëve. U fol më herët për sport e hiq fare nga ju anëtarë të kuvendit nuk u përmend bujqësia dhe mundësitë buxhetore të sajë, përveç kryesuesi që e ka përmend. Të përgjigjem në pyetjen, kemi nisë procedurat në një afat të përshpejtuar por kanë dalë çmimet më të larta për 70%, dhe në mungesë të mjeteve – buxhetit jemi detyruar që të anulojmë tenderin e serave.
- z. Xhevxhet Berisha:** Përshëndetje të gjithëve. Kam dy pyetje që vijnë nga Fshati Resnik dhe tjetra nga fshati Volljak, Qupevë e lartë dhe Dush. Në seancën e kaluar e kam ngrit problemin e gropave në rrugë dhe ju kam lutë që ta merr dikush nga drejtoritë përsipër. Shpresoj që gjatë këtij muaji drejtori i SHP, Iber Elezi do ta kryej. Ndërsa për drejtorin Lorenc Marleku ka të bëjë pyetja për kanalizimin që është kryer në Resnik dhe që në projekt ka qenë e paraparë të ndërtohet një muri diku 60 metra lineare, të lartë dy metra etj. A ka mundësi që të kryhet kjo apo nuk keni mundësi.
- z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizmit:** E dijë se për çfarë është fjala. Gjatë realizimit të projekteve në Resnik e kemi parë që duhet ndërtuar ai muri shkaku i sigurisë së shtëpive. Nuk kemi pasur mundësi ta zbatojmë shkaku i mungesës së mjeteve por gjithsesi që do ta kryejmë me rishikim të buxhetit sepse është shumë i arsyeshëm ndërtimi i atij muaji.
- z. Arben Limanaj:** Një lagje minoritare në fshatin Poterq kanë shprehur interesimin për lidhje në kanalizimi që është në proces të ndërtimit në këtë fshat.
- z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizmit:** Unë sot kam qenë në atë fshat dhe lagje. Disa banorë atje nuk po lejojnë që të kalon kanalizimi nëpër prona të tyre. Kanalizimi shkon në vija të drejta dhe ne nuk kemi mundësi që të i lidhim të gjithë në shtëpia. Është një familje shumë e varfër moniritare atje të cilën e kemi ndihmuar dhe e kemi lidhur.
- z. Isa Ibishi:** Përshëndetje për ju kryesues dhe për të gjithë të pranishmit. Dëshiroj të bëjë një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Ura ne fshatin Dugujevë ka lëvizur dhe është e rrezikshme nëse mbi të lëvizin automjetet me pesha të rënda. Do të ishte mirë që të bëhen preventiva dhe të mos lejohej të qarkullonin mbi atë urë mjetet me pesha të rënda.
- z. Iber Elezi, drejtor i SHP:** E vërtetë që ura ka lëvizur mbështetje nga vërtshimet. Kemi marr informacion nga banorët e asaj pjese dhe menjëherë

kemi shkuar atje me ekip të inzhinierve, arkitektët dhe ndërtimtarët. E kemi konstatuar se gjendja e asaj ure është serioze sepse ka rrëshqitje të sajë. Në të ardhmen duhet të mendojmë që atë ura ta ndërrojmë komplet por deri atëherë kemi marr masa preventive duke grumbulluar një sasi të konsideruar me zhavorr aty përfund në mënyrë që në rast aksidenti të mos ketë pasoja fatale. Ndërkohë edhe kompaninë e kemi angazhuar që të bëjë prerjen e asfaltit diku në gjatësi 30 metra dhe të asfaltohet serish ajo pjesë që ka rrëshqit. Besoj që shumë shpejt do të kryhet.

Kjo ishte edhe pyetja dhe përgjigja e fundit e kësaj seance të Kuvendi, Kjo mbledhje e kuvendit u mbyll me një ceremoni të rastit ku drejtori i Administratës, z. Binak Sylaj i dorëzoi një dhuratë znj. Grishe Gashi me rastin e pensionimit të sajë.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesi:

Fadil Gashi

